

Vendim nr. 111 datë 25.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 25.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (Xh) 2023 të Regjistrarit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: XHEVIT SATKA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-4349 (474), datë 10.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Konstatimi i shkeljes së procesit të rregullt në aspektin e zhvillimit të procesit në një kohë të paarsyeshme.

BAZA LIGJORE: Nenet 2, 15, 31, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit Skrapar, me vendimin nr.116, datë 20.10.1964 (*vendimi nr. 116/1964*), ka miratuar birësimin e shtetasit V. S. nga shtetasit J.S. dhe Xh. S. Në vijim, ky birësim është pasqyruar edhe në regjistrat e gjendjes civile. Shtetasi

Xhevit Satka (kërkuesi) ka pretenduar se me të njëjtin vendim është birësuar edhe ai. E ndjera Xh. S. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar me kërkesëpadi, me pretendimin se ajo ka birësuar vetëm shtetasin V.S. Pas vdekjes së saj, gjykimi ka vazhduar nga paditësi V. S., si trashëgimtar i saj. Kërkuesi ka hyrë në gjykim me cilësinë e personit të tretë, duke u bashkuar me palët e paditura, këshillin e qarkut Berat dhe Zyrën e Gjendjes Civile, Skrapar. Po kështu, në gjykim kanë hyrë si ndërhyrës kryesorë S. dhe K. M., nipër të të ndjerit J. S. dhe G. G., nipi i të ndjerës Xh. S., të cilët kanë kërkuar pavërtetësinë e vendimit nr. 116/1964 dhe rregullimin (korrigjimin) e akteve të gjendjes civile, duke u fshirë si bijtë e të ndjerëve të mësipërm, si shtetasi V. S., ashtu edhe kërkuesi. Gjithashtu, me cilësinë e ndërhyrësit kryesor është futur në gjykim edhe shtetasja turke N. O. Me vendimin nr. 92, datë 04.11.1997, Gjykata e Kasacionit ka vendosur transferimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Me vendimin nr. 4499, datë 24.12.1998, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë dhe deklarimin si të pavërtetë të vendimit nr.116/1964, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.649, datë 27.04.1999. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1055, datë 03.11.1999, ka vendosur prishjen e këtyre dy vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Skrapar. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.76, datë 05.07.2001, kanë vendosur mospranimin e rekursit në interes të ligjit të paraqitur nga shtetasi V. S. kundër vendimit nr.1055, datë 03.11.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

3. Pas dërgimit për rishqyrtim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Skrapar, me vendimin e datës 24.05.2000 ka vendosur pushimin e gjykimit për shkak të mosparaqitjes së shtetasit V.S. si paditës në gjykim. Në datën 08.04.2001 ky shtetas ka paraqitur përsëri padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Skrapar, me të njëjtin objekt e shkak ligjor.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Skrapar, me vendimin nr. 106, datë 08.04.2003, ka vendosur: *“Të pranojë padinë e paditësit V. S. dhe pjesërisht padinë e personave të tretë S. M., K. M. dhe G. G.. Të njohë të pavërtetë vendimin nr. 116 datë 20.10.1964 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit Skrapar dhe në bazë të nenit 270 të Kodit të Procedurës Civile ta godasë atë si të falsifikuar. Të njohë faktin juridik se paditësi V. S. është birësuar nga bashkëshortët J. dhe Xh. S. me vendimin nr.116, datë 20.10.1964. Të urdhërojë Zyrën e Gjendjes Civile të korrigjojë aktet e saj, duke çregjistruar Xh. S. nga trangu i familjes së J. S. dhe duke i hequr atij atësinë J. dhe amësinë Xh. Të përjashtohet Xh. S. nga trashëgimtar i radhës së parë i të ndjerëve J. e Xh. S. Rrëzimin e kërkimeve të tjera të personave të tretë S. M., K. M. dhe G. G.. Pushimin e padisë së ndërhyrëses kryesore në bazë të nenit 299/c dhe 179 të Kodit të Procedurës Civile.”.*

5. Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 98, datë 09.07.2003, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 106, datë 08.04.2003 të Gjykatës së Rrethit Skrapar.”*.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 539, datë 03.02.2005 ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 106, datë 08.04.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Skrapar dhe të vendimit nr. 98, datë 09.07.2003 të Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe rrëzimin e padisë së paditësit V. S. dhe të personave të tretë S. M., K. M., G. G. dhe N. O.”*. Shtetasi V. S. i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për kundërshtimin e këtij vendimi.

7. Me vendimin nr.17, datë 30.04.2007, Gjykata ka vendosur: *“Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 539, datë 03.02.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë”*, me argumentin se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e barazisë së armëve, për sa u përket mundësive të barabarta të palëve për të organizuar mbrojtjen në gjykimin në atë kolegji.

8. Në rishqyrtim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2008-1148 (460), datë 09.12.2008, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 98, datë 09.07.2003 të Gjykatës së Apelit Vlorë.”*.

9. Në datën 05.12.2015 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë me objekt rishikimin e vendimit nr. 00-2008-1148 (460), datë 09.12.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me pretendimin se kishte rënë në posedim të një prove të re shkresore, e cila paraqiste rëndësi për çështjen, në kuptim të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-4349 (474), datë 10.11.2022, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesës së kërkuetit Xhevit Satka për rishikimin e vendimit nr. 00-2018-1148 (460), datë 09.12.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë”*, me argumentin se prova e paraqitur si e re nga kërkuesi, konkretisht vendimi nr. 116/1964, nuk mund të shërbejë si *“provë e re”* për rishikimin e vendimit në kuptim të nenit 494/a të KPC-së, pasi pala kërkuete ka qenë në dijeni të ekzistencës së saj dhe rezulton që ky akt i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, nga ku rezulton me vendim përfundimtar të gjykatës se ai është njohur si i pavërtetë.

11. Në datën 30.03.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuetit

12. **Kërkuesi** ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt në drejtim të:*

- 12.1. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë të kundërt dhe në dëm të kërkuesit, duke argumentuar se prova e paraqitur nuk konsiderohet si “provë e re”, kur në fakt ajo përbën aktin origjinal të vendimit nr. 116/1964 dhe nuk i është nënshtruar më parë shqyrtimit gjyqësor.
- 12.2. *Së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar kërkuesin me shkresë zyrtare, në mënyrë që ai të paraqiste pretendimet me shkrim dhe nëse ka pasur prova për të paraqitur brenda një afati 15-ditor përpara datës së shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Gjykata e Lartë duhet ta kalonte çështjen në seancë plenare me praninë e palëve për të debatuar në lidhje me shkaqet e kërkesës për rishikim.
- 12.3. *Së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi procesi gjyqësor është zhvilluar në një periudhë të gjatë e të paarsyeshme.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

15. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues

individual, për rrjedhojë, si bartës i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, të pretenduar të cenuar, provon interesin e tij të drejtpërdrejtë.

16. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Shterimi i mjeteve juridike efektive nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me procesin e rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se vlerësimi i respektimit të standardeve kushtetuese gjatë këtij procesi i nënshtrohet juridiksionit kushtetues (*shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 61, datë 27.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në drejtim të këtij kriteri, Kolegji vëren se në rastin konkret kërkuesi i është drejtuar Gjykatës, duke i parashtruar asaj dy kërtime në objekt. Kërkimi i parë lidhet me konstatimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi procesi gjyqësor është zhvilluar në një periudhë të gjatë e të paarsyeshme, ndërsa kërkimi i dytë lidhet me shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-4349, datë 10.11.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, për shkak të cenimit të procesit të rregullt ligjor.

18. Në lidhje me kërkimin e parë, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës dhe përmbajtjes së saj, Kolegji konstaton se ai është parashtruar nga kërkuesi drejtpërdrejt përpara Gjykatës, duke mos shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive që ai ka pasur në dispozicion, sipas neneve 399/1 – 399/12 të KPC-së. Si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit, duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për këtë kërkim, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Ndërsa në lidhje me kërkimin tjetër ai nuk ka mjete të tjera për të shteruar përpara se t’i drejtohet Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, për rrjedhojë e plotëson këtë kriter.

19. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi më i fundit

i kundërshtuar nga kërkuesi mban datën 10.11.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 30.03.2023. Lidhur me këtë fakt, rezulton se në datën 16.03.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila me shkresën nr. 1666/1, datë 27.03.2023 i ka komunikuar atij se vendimi "... është bërë i disponueshëm për palët, në datën 06.01.2023, ndërkohë që ky vendim është publikuar dhe në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë po në datën 06.01.2023". Për rrjedhojë, kërkesa përmbush edhe kriterin e legjitimitetit *ratione temporis*.

20. Në lidhje me kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*, pretendimet e kërkuesit *prima facie* janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit

21. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë të kundërt dhe në dëm të tij, duke argumentuar se prova e paraqitur nuk konsiderohet si "provë e re", kur në fakt ajo përbën aktin origjinal të vendimit nr. 116/1964 dhe nuk i është nënshtruar më parë shqyrtimit gjyqësor.

22. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, si dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Lidhur me kërkesën për rishikim, Gjykata është shprehur se ajo përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm,

pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (*shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr.36, datë 26.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se, për sa i përket shqyrtimit paraprak mbi rëndësinë e provës së re, ai është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon kjo Gjykatë (*shih vendimet nr. 7, datë 07.03.2011; nr. 4, datë 25.02.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se kërkesa për rishikim e paraqitur nga kërkuesi është marrë në shqyrtim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, ka analizuar pretendimet e paraqitura dhe është shprehur për thelbin e tyre, duke arsyetuar se prova e paraqitur si “e re” nga kërkuesi Xhevit Satka, konkretisht vendimi nr. 116/1964, nuk përbën shkak, për rrjedhojë nuk mund të shërbejë si “prove e re” për rishikimin e vendimit në kuptim të nenit 494/a të KPC-së. Ky kolegji ka argumentuar se kërkuesi ka qenë në dijeni të ekzistencës së këtij vendimi dhe rezulton që ky akt i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe me vendim përfundimtar të gjykatës ai është njohur si i pavërtetë (*shih paragrafët 36-37 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

25. Ndërsa për sa i përket pretendimit të kërkuesit se vendimi nr. 116/1964 i paraqitur si shkak për rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë përbën provë të re, Kolegji çmon se është në kompetencën e kësaj gjykate të vlerësojë nëse kërkesa për rishikim e paraqitur përpara saj plotëson kërkesat e ligjit ose nëse është e bazuar. Prandaj, Kolegji vlerëson se vendimi objekt kundërshtimi nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë, për rrjedhojë ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u dëgjuar dhe asaj për t’u mbrojtur

26. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar me shkresë zyrtare në mënyrë që ai të paraqiste pretendimet me shkrim dhe nëse ka pasur prova për të paraqitur brenda një afati 15-ditor përpara datës së shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Gjykata e Lartë duhej ta kalonte çështjen në seancë plenare me praninë e palëve për të debatuar në lidhje me shkaqet e kërkesës për rishikim.

27. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t’u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat

e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar e për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 37, datë 30.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Ligji procedural civil ka parashikuar se shqyrtimi i kërkesës për rishikim bëhet sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi, në rastin konkret sipas rregullave të përcaktuara për gjykimin në Gjykatën e Lartë në Titullin II, Pjesa e Tretë, të KPC-së. Bazuar në këto dispozita, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit (*neni 482, pika 1, i KPC-së*). Për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë ligji procedural civil përcakton se sekretaria e saj njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykit të paktën 15 ditë përpara. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara ose të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa (*neni 482, pika 3, i KPC-së*).

29. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuuesi ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me kërkesën për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, si një formë e ankimit të jashtëzakonshëm. Referuar të dhënave të publikuara në faqen e internetit të kësaj gjykate, në rubrikën “Çështje të shpallura në gjykim”, konstatohet se në datën 25.10.2022, kjo gjykatë ka bërë shpalljen e listës së çështjeve civile për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 10.11.2022, ku përfshihet edhe çështja e kërkuetit, si dhe përbërja e trupit gjykues. Gjithashtu, referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, nuk rezulton që kërkuuesi të ketë paraqitur të dhënat e postës elektronike (*e-mail*) në kërkesën për rishikim, për qëllim të njoftimit edhe në rrugë elektronike, sipas nenit 482, pika 3, të KPC-së ose pikës 5 të urdhrin nr. 131, datë 02.07.2021 të Gjykatës së Lartë “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve”. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale që rregullojnë njoftimin e palëve në atë gjykatë.

30. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar për shkak të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit dhe jo në seancën gjyqësore, Kolegji çmon se ai është haptazi i pabazuar. Ky konkluzion mbështetet në faktin se, nga njëra anë, Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit ka ushtruar funksionin e saj seleksionues, duke vlerësuar paraprakisht nëse kërkesa për rishikim plotësonte kërkesat e nenit 494/a të KPC-së dhe, nga ana tjetër, se kërkuuesi nuk ka paraqitur asnjë argument kushtetues në lidhje me këtë shkak.

31. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.